



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1672 Prot.

Tiranë, më 08.09 2026

URDHËR

Nr. 25 dt. 08.09 2026

“PËR

ZBATIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR.108, DATË 15.06.2026 TË QSHA DHE QNRRASH “PËR MIRATIMIN E KANLENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027”, RAUNDI I DYTË”

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të QSHA dhe QNRRASH nr.108, datë 15.06.2026, në Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkursin e pranimit janë si vijon:
 - 18 shtator 2026 deri në orën 10:00 të datës 20 shtator 2026 per Fakultetin e Shkencave te Levizjes
 - 18 shtator 2026 deri në orën 10:00 të datës 21 shtator 2026 për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
2. Dokumentet që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurset e pranimit janë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje e kartës së identitetit
 - Mandat pagesa e tarifës së konkursit
 - Kartela mjekësore
3. Konkursi i pranimit për programin e ciklit të parë në “Shkenca të Lëvizjes” në FSHL, do të zhvillohet në datën **20 shtator 2026**; e cila afishohet në faqen zyrtare të UST-së.
4. Konkursi i pranimit për programin e ciklit të parë në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit” në FVFR, do të zhvillohet në datën **21 shtator 2026**; e cila afishohet në faqen zyrtare të UST-së.
5. Përlllogaritja e mesatares për pranimin në programin e ciklit të parë në “Shkenca të Rehabilitimit” në FSHR, do të zhvillohet në datën **21 shtator 2026**. Ngarkohet Dekanati i

FSHR për përcjelljen pranë Rektoratit të propozimit për ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve dhe komisionit të ankimimit për konkursin e pranimit.

6. Fakultetet të marrin masat për sigurimin e bazës materiale të domosdoshme për zhvillimin e konkursit të pranimit. Gjatë ditëve të konkursit duhet të jetë i pranishëm një nga mjekët e secilit fakultet bashkë me materialet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë.
7. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes), të komunikojnë me subjektet përkatëse për të siguruar mosndërprerjen e energjisë elektrike gjatë muajit shtator 2026. Për një mbarëvajtje sa më të mirë dhe cilësore, të sigurohet gjithashtu edhe shërbimi i përforcuar nga Komisiariati i Policisë për mbikqyrjen e konkursit të pranimit.
8. Regjistrimet e fituesve në programet e studimit të ciklit të parë bachelor për të tre fakultetet janë në datat **25 shtator** deri në **04 tetor 2026** (25-26 shtator, 27-28 shtator, 29-30 shtator, 01-02 tetor, 03-04 tetor 2026).
9. Grafiku i daljes në punë të personelit administrativ, në zbatim të këtij Urdhëri do të jetë si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Datat e angazhimit
1	Laura Kokomani	Staf administrativ	19, 20, 26, 27 shtator dhe 3, 4 tetor 2026
2	Pranvera Lozi	Staf administrativ	19, 20, 26, 27 shtator dhe 3, 4 tetor 2026
3	Mimoza Reçi	Staf administrativ	19, 20, 26, 27 shtator dhe 3, 4 tetor 2026
4	Paola Gjonaj	Staf administrativ	26, 27 shtator dhe 3, 4 tetor 2026

10. Orari zyrtar për zbatimin e këtyre procedurave do të jetë nga ora 08:00 deri 15:30. Ditët e paflektuara në grafik janë ditë normale të punës.
11. Për të gjithë punonjësit e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ që për shkak të këtij Urdhëri janë të detyruar të ndërpresin lejen apo ditët e pushimeve të fundjavës dhe/ose ditë pushimi zyrtare, likujdimi i detyrimit nga ana e Institucionit do të kryhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
12. Ngarkohen Dekanatet e Fakulteteve, Administratori i UST-së, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit; të marrin masa për plotësimin e të gjitha detyrimeve dhe zbatimin dhe publikimin e këtij Urdhëri.
13. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASAJ

